



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1366/2 Prot.

Tiranë, më 28.12.2023

**V E N D I M**

**Nr. 265, Datë 28.12.2023**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 263, datë 13.12.2023, e paraqitur nga E.Xh kundër Shkollës “Prenk Jakova” Shkodër, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër (në vijim ZVAP Shkodër) dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë (në vijim DRAP Lezhë) në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Ka përfunduar Shkollën e Mesme Artistike për specialitetin piano në vitin 1991. Në vijim, në vitin 2000, ankuesja ka përfunduar studimet e larta pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në degën Histori-Gjeografi. Ankuesja ka filluar punë si mësuese e pianos në Shkollën e Mesme Artistike “Prenk Jakova” me datë 01.02.1998 dhe ka kryer dy shkallët e kualifikimit.

Me vendimin pa numër, datë 16.09.2015, nr. 174/12 prot, të nxjerrë nga drejtoria e shkollës, është vendosur kalimi i E.Xh, si mësuese e lëndës Histori-Gjeografi. Sipas drejtorit, ky vendim është marrë në zbatim të Urdhrit të MAS nr. 363, datë 16.09.2014 “Për caktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit parauniversitar”. Me datë 25.10.2016 i janë

*ndërprerë marrëdhëniet financiare si mësuese e pianos dhe kanë filluar ato si mësuese e lëndës histori-gjeografi, të cilat vazhdojnë dhe aktualisht.*

*Ky veprim i kryer nga drejtori i shkollës është në kundërshtim me legjislacionin arsimor në fuqi, pasi është jashtë kompetencave të tij. Bazuar në ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore, në asnjë rast nuk i jepet e drejta drejtorit të shkollës të heqë një person nga pozicioni i mësueses dhe më pas ta emërojë si mësuese të një lënde të caktuar. Edhe pas ankesave të shumta me gojë dhe në rrugë postare që ka bërë, jo vetëm tek drejtori i shkollës, por edhe tek ZVAP Shkodër, si dhe tek DRAP Lezhë, nuk është marrë asnjë masë për ndalimin e kësaj paligjshmërie, madje nuk kanë kthyer përgjigje zyrtare për ankesën e bërë.*

*Për të konfirmuar që vendimi i drejtorit është i pabazuar ligjërish, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me Vendimin nr. 1320, datë 26.11.2018, në pikën 2, ka konstatuar pavlefshmërinë e vendimit pa numër të datës 16.09.2015, të Drejtorit të Shkollës së mesme Artistike “Prenk Jakova”. Gjithashtu, me Vendimin nr. 163, datë 04.04.2022, Gjykata e Apelit Shkodër shkruan në fund të materialit ku jepet vendimi, ndërmjet të tjerash edhe: “... Detyrimin e palëve të paditura ... (pavlefshëmëri absolute e vendimit)...”. Pra, është shumë e qartë që të dy vendimet e gjykatave e quajnë pavlefshëmëri absolute vendimin e drejtorit të shkollës.*

*Ky veprim i drejtorit të shkollës ka filluar që në vitin 2016 (me ndryshimin e marrëdhënieve financiare) dhe ka vazhduar çdo vit e çdo muaj deri tani. Pra, theksoj se edhe aktualisht po vuaj një trajtim të padrejtë nga ky drejtor, pa asnjë bazë ligjore, duke qenë e detyruar të përgatis të gjithë dokumentet përkatëse (plane pune, raporte, etj) në një pozicion pune që i është caktuar në mënyrë të paligjshme. Ky vendim i drejtorit të shkollës “Prenk Jakova” është bërë vetëm për E.Xh, duke e diferencuar nga të tjerët pa asnjë bazë ligjore. Ky veprim nga ana e drejtorit është kryer për arsye të gjendjes arsimore që ka, nga arsimimi në po këtë shkollë artistike.*

*Në përforcim të situatës të saj të kualifikimit dhe mundësisë për të mbajtur vendin e punës si mësuese pianoje është shprehur edhe Vendimi nr. 163, datë 04.04.2022 i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili në faqen 20 ndërmjet të tjerash shpreh që: “... Së pari mungesa e arsimit përkatës për një mësues që ushtron detyrën e tij për rreth 18 vjet nuk është dhe nuk mund të jetë shkak i justifikuar dhe i ligjshëm për zgjidhjen e marrëdhënies së punës në kuptim të Kodit të Punës .....”.*

*Së fundi, dua të theksoj edhe një herë që unë vazhdoj të trajtohem në mënyrë diskriminuese nga drejtori i shkollës “Prenk Jakova” duke qenë çdo muaj dhe çdo vit e detyruar të zbatoj një vendim të drejtorit të cilin gjykatat e kanë quajtur absolutisht të pavlefshëm”.*

*Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin dhe ndalimin e diskriminimit nga ana e drejtorit të Shkollës së Mesme Artistike “Prenk Jakova”, pas datës 04.04.2022.*

Konstatimin e diskriminimit nga ana e ZVAP Shkodër për mosveprim, pas Vendimit të Apelit datë 04.04.2022.

Konstatimin e diskriminimit nga ana e DRAP Lezhë për mosveprim. Bazuar në kompetencat e Komisionerit, kërkon arritjen e një marrëveshjeje me ZVAP Shkodër dhe/ose DRAP Lezhë për dhënien e mundësisë për të realizuar edhe shkallën e fundit të kualifikimit.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimorë ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në nenin 12, pika 1, germa c), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: .....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre*

*gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë KMD-së, konstatohet se:

Së pari, E.Xh me ankesën nr. 199, datë 16.12.2022, drejtuar KMD-së, ka pretenduar se është diskriminuar nga vendimi (pa numër) datë 16.09.2015, i nxjerrë nga Drejtori i Shkollës së Mesme Artistike “Prenk Jakova”, është diskriminuar për moszbatimin e vendimit gjyqësor nr. 163, datë 04.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe për moszbatimin e vendimit të gjykatës, për sa i përket urdhërimit që ajo ka bërë për të rikthyer ankuesen në vendin e mëparshëm të punës si mësuese pianoje.

Nga verifikimet e kryera rezulton se pretendimet e parashtruara nga ankuesja janë shqyrtuar nga KMD, në kuadër të ankesës së mësipërme, për të cilën Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është shprehur me Vendimin nr. 155, datë 07.08.2023, në të cilin ka vendosur:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses E.Xh, nga ana e z. A.K, Drejtor i Shkollës së Mesme Artistike “Prenk Jakova” dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Për sa më sipër, Komisioneri, mbështetur në nenin 33, pika 4/c e LMD, të ndryshuar, i cili përcakton se: *“Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”*, gjykon se pretendimi i ankueses për diskriminim nga Shkolla “Prenk Jakova” Shkodër dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër, nuk mund të pranohen për shqyrtim<sup>1</sup>.

Së dyti, referuar shpjegimeve të cituara në ankesë dhe materialeve bashkëngjitur saj, rezulton që nuk është dërguar asnjë informacion dhe dokumentacion lidhur me pretendimin kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë.

Për sa më sipër, referuar nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ..... ç) ..... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; ....., Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.*

---

<sup>1</sup> Për analogji citojmë vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të Komisionerit.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 4/c/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

## **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës nr. 263, datë 13.12.2023, të paraqitur nga E.Xh kundër Shkollës “Prek Jakova” Shkodër, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë, pasi është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**